



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:147878
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05617390

C.nr.1154/23

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala në çështjen juridike të paditësit A.H., nga Gjakova, rr. “...” numër .., ndaj të paditurës Posta e Kosovës Sh.A., ne seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Ademi jurist i diplomuar, me objekt kontesti kontest punë me datë 23 prill 2024 mori këtë :

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditësit A.H., nga Gjakova, të parashtruar me datë , që bartë numrin e lëndës C.nr. 2023:147878 (1154/23), e paraqitur kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh.a., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti për kontest pune (anulim vendimi).

II. Secila pale i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi A.H. nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 16.06.2023 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Posta e Kosovës me objekt kontesti anulim i vendimit.

Lidhur me këtë çështje juridike, gjykata ka caktuar seancën përgatitorë për datën 23.04.2024, për të cilën seance paditësi ka qene i ftuar në mënyrë të rregullt (pasi që thirrja për seancën e caktuar i është dorëzuar anëtarit të familjes pas lënies së njoftimit) nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Ndërsa prezent ka qene i autorizuari i të paditurës, i cili ka nuk ka kërkuar që seanca të bahet në mungesë të paditësit, por nga ana e gjykatës ka kërkuar që të veprohet konform dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, ashtu që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr.

Në rastin konkret, gjykata duke aplikuar nenin 409 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje: LPK), PK-së ku parashihet se *“Në qoftë se në seancën përgatitorë nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, dhe faktin se i autorizuari i paditësit ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, erdhi në përfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat, duke u bazuar edhe nën nenin nenin 490.1 e lidhur të LPK-së, gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i Përgjithshëm -
C.nr. 1154/23, datë 23 prill 2024

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.